



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA



THIRRJE PËR OJQ PËR BASHKËPUNIM ME PROFESIONISTË TË DIASPORËS

Qëllimi i thirrjes

Ftojme organizatat e shoqërisë civile në Kosovë, të interesuara për angazhimin e profesionistëve nga diaspora, të aplikojnë për të përfituar nga programi "Angazhimi i Profesionistëve të Diasporës".

Angazhimi i profesionistëve të diasporës në fushat ku në Kosovë ka mungesë të ekspertizës dhe njohurive do të ndihmonte OJQ-të të zhvillojnë kapacitete të reja dhe të specializohen në fushat e punës së tyre, kështu duke mundësuar adresim më të mirë të problemeve dhe nevojave të qytetarëve.

Duke shfrytëzuar rrjetin e vet të profesionistëve të diasporës, GERMIN do të angazhojë potencialin e diasporës për përfitim publik në Kosovë. Ky angazhim jo vetëm që ndihmon OJQ-të në Kosovë, por gjithashtu krijon mundësi për bashkëpunim ndërmjet ekspertëve të diasporës dhe qytetarëve dhe ekspertëve në Kosovë, kështu duke kontribuar edhe në forcimin e lidhjeve mes komuniteteve të ndryshme dhe diasporës. Ky aktivitet zhvillohet në kuadër të Programit për Angazhim Qytetar, që zbatohet nga KCSF në partneritet me USAID në Kosovë. GERMIN është partnere e KCSF në realizimin e këtij aktiviteti.

Sfondi dhe përshkrimi i shkurtër i projektit

Diaspora luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor të Kosovës duke dhënë një kontribut të çmuar në mbrojtjen e të drejtave individuale dhe sociale, ruajtjen e gjuhës dhe identitetit, mbrojtjen e interesave kombëtare dhe zhvillimin ekonomik dhe social të Kosovës. Kontributi i diasporës ka qenë vendimtar në të kaluarën, duke qenë kontribuuesi kryesor ekonomik dhe avokuesi më i fuqishëm politik për Kosovën deri në fund të shekullit të 20-të. Dinamika e diasporës ka ndryshuar me gjeneratat e reja të emigrantëve të Kosovës, të rritur dhe të arsimuar në vendet më të zhvilluara perëndimore. Ata përfaqësojnë një pasuri të vlefshme për vendin tonë tani. Megjithatë, ka shumë sfida për të krijuar një mjedis që i inkurajon dhe i mbështet diasporën e Kosovës që të ndajnë dhe transferojnë njohuritë, përvojat dhe talentet e tyre në Kosovë.

Programi për Angazhim Qytetar është iniciativë pesë vjeçare që zbatohet nga KCSF në partneritet me USAID në Kosovë. Qëllimi kryesor i këtij programi është të ushqejë kulturën e aktivizimit që e bën jetën në lagjet dhe qytetet tona më të mirë, më të kujdesshme dhe më kuptimplote. Nëpërmjet aktiviteteve të tij, Programi për Angazhim Qytetar do të realizojë një numër të veprimeve të bazuara në tri shtylla thelbësore: angazhimin e komunitetit, rritjen e besimit ndërshtetëror si dhe zgjerimin e mobilizimit të burimeve të reja.

Në kuadër të mobilizimit të burimeve të reja për OJQ-të dhe duke dashur të adresohen mungesat e ekspertizës profesionale në fusha specifike tematike në dispozicion të OJQ-ve, si dhe duke shfrytëzuar potencialin e ekspozimit ndaj ideve të reja dhe metodologjive të punës të ofruara nga diaspora, KCSF në bashkëpunim me GERMIN do të ofrojë mundësi për bashkëpunim dhe ndërveprim në mes të OJQ-ve në Kosovë dhe profesionistëve e profesionisteve të diasporës.

Kohëzgjatja e angazhimit dhe kushtet

Angazhimi i ekspertëve nga diaspora është planifikuar të jetë me prezencë fizike¹, ndërsa natyra e angazhimit të profesionistëve të diasporës është vullnetare. Forma e punës do të përcaktohet gjatë periudhës së përgatitjes së angazhimit, e cila do të bartet edhe në marrëveshjen me shkrim mes dy palëve. Përsa i përket shpenzimeve, GERMIN do të mbulojë shpenzimet ditore, dhe sigurimin shëndetësorë përmes një shume javore, në kuadër të së cilës hyjnë edhe shpenzimet e biletës vajtje-ardhje.

Angazhimi i profesionistëve të diasporës është paraparë për periudhën prill-qershor 2023. Gjatë kësaj kohe eksperti/tja nga diaspora mund të angazhohet së paku 3 javë deri maksimumi 3 muaj.

Detyrat që do të kryhen në kuadër të këtij angazhimi

- Në koordinim me GERMIN, OJQ-ja pritët të angazhojë një ekspert/e bazuar në nevojat dhe preferencat specifike;
- Mënyra e dhënies së ekspertizës përcaktohet me ndërmjetësimin e GERMIN dhe atë ndërmjet ekspertit/es dhe OJQ-së përfituese.
- OJQ pritët të ndjekë dhe përmbushë kriteret e cekura më poshtë në një marrëveshje të përbashkët të nënshkruar ndërmjet ekspertit dhe OJQ-së.

Dokumentet e nevojshme për aplikim

Dokumentet	Përmbajtja
Dokumentet administrative	- Certifikata e regjistrimit të OJQ-së;

¹ Në rast se vlerësohet e nevojshme, palët mund të kenë edhe takime online, qoftë si punë përgatitore para nisjes së angazhimit me prezencë fizike në Kosovë, apo në përfundim të këtij angazhimi.

	- Deklarata e Administratës Tatimore të Kosovës që dëshmon se OJQ nuk ka obligime tatimore; - Statuti i organizatës, strategjia (nëse ka një të tillë), ose përmbledhja e misionit, vizioni në një dokument; - Dëshmi për projektet e realizuara dhe buxhetin vjetor të organizatës për 3 vitet e fundit.
Letër interesi për angazhimin e ekspertit/es së diasporës (maksimumi 2 faqe)	Një letër të shkurtër interesi që tregon nevojën dhe përkushtimin për të angazhuar ekspertë të diasporës në fushën specifike të nevojshme për organizatën, duke përfshirë: - Arsyet kryesore për angazhimin e mbështetjes profesionale për fushat e nevojshme në organizatën tuaj përfshi edhe arsyetimin se pse kjo ekspertizë nuk mund të sigurohet në Kosovë; - Deklaratë për kapacitete të mjaftueshme njerëzore dhe teknike që sigurojnë përmbushjen dhe realizimin për nevojën për ekspertizë nga diaspora; - Lidhja e nevojave të organizatës të jetë në përputhje me objektivat e kësaj thirrjeje; - Përfitimi që organizatës pritët ta ketë nga kjo ekspertizë dhe arsyet/vlera e shtuar e angazhimit të dikujt nga diaspora; - Zotimi për bashkëpunim dhe angazhim në adresimin e rekomandimeve të ekspertit; - Plani i aktiviteteve që planifikohet të realizohet brenda periudhës së angazhimit.
Kërkesat Teknike	Ky seksion duhet të përfshijë informacion mbi: - Koha e preferuar dhe periudha e angazhimit të një eksperti; - Sigurimi i zyrës/hapësirës së punës për ekspertin/en; - Asistimi i ekspertit duke ofruar informacionin e nevojshëm, organizimin e takimeve dhe aspekte të tjera logjistike që sigurojnë respektimin e angazhimit.

Bashkëpunimi mes organizatës dhe ekspertit/es së përzgjedhur do të konsiderohet i suksesshëm nëse do të ketë bashkëpunim të ngushtë mes OJQ përfituese, ekspertit/es së përzgjedhur dhe GERMIN. Për këtë qëllim raportimi tek GERMIN duhet të jetë në baza javore e mujore. Raporti përfundimtar mbi ndikimin e angazhimit të kontributit duhet të bëhet nga OJQ përfituese dhe eksperti i përzgjedhur duke cekur përmbushjen e objektivave dhe aktiviteteve të dakorduara.

Kriteret vlerësuese për përzgjedhje të OJQ-ve

- Plotësimi i dokumenteve administrative (20 pikë vlerësimi)
- Letër interesi për angazhimin e ekspertit të diasporës (50 pikë vlerësimi)
- Plotësimi i kërkesave teknike (30 pikë vlerësimi)

Vetëm OJQ të kalojnë pragun e 70 pikëve do të kontaktohen dhe do të përzgjidhen për fazën e ardhshme të ndërlidhjes me profesionistë të diasporës. Në rast të mos gjetjes së profesionistit/es së përshtatshme për OJQ aplikuese, GERMIN gëzon të drejtën të ftojë OJQ në listë rezervë.

Afati i fundit i aplikimit

Të gjitha aplikimet duhet të dorëzohen në GERMIN në mënyrë elektronike në edp@germin.org me titull: *Aplikimi EDP-CEA*. Për më shumë informata rreth kësaj thirrje mund të na kontaktoni përmes info@germin.org.

Data e fundit për dorëzimin e aplikacioneve është **26 mars 2023**.